



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.369/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj -anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.02.2025, merr këtë:

VE N D I M

- I. PRANOHET e bazuar ankesa e subjektit politik Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.369/2025 e datës 04.02.2025
- II. Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 3,000.00 (tremijë) euro.
- III. Detyrohet Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datën 04.02.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se më datë 03 Shkurt 2025, Selman Kolgeci, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, ka postuar disa fotografi në llogarinë e tij në facebook, me tekst shoqërues, të realizuara në hapësirat e brendshme dhe të jashtme të Bashkësisë Islame në Suharekë, në kundërshtim me dispozitat ligjore zgjedhore, duke shfrytëzuar kështu burimet dhe institucionet fetare për qëllime elektorale, ku me këtë veprim është shkelur neni 5 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 i Rregullores zgjedhore Nr.07/2024.Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë fotografi dhe linkun

https://www.facebook.com/story.php?story_fbid=10229983413863767&mibextid=wwL3R9Ifr&rdid=b6PTfOsbAeK573v1#

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

Ankesa është bazuar

Paneli pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore, ka gjetur se nga fotot e ofruara si prove dhe postimi i të njëjtës në rrjetin social facebook, nga Selman Kolgeci, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, është vërtetuar se ka bërë fushatë me përfaqësues fetar të realizuara në hapësirat e brendshme dhe të jashtme të Bashkësisë Islame në Suharekë. Nga prova materiale e bashkangjitur ankesës, së Subjektit Politik LVV, dhe shkresave tjera të lëndës, paneli ka vlerësuar se nga ana e kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik, LDK, është shkëlur Rregulla Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, pasi që kandidati në fjalë, në fushatë zgjedhore ka vizituar Këshillin e Bashkësisë Islame, si dhe përfaqësues fetar, për fushatë zgjedhore, veprim ky i cili bie në kundërshtim me dispozitën e nenit 5 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 i Rregullores Zgjedhore 07/2024.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi si të bazuar.

Gjithashtu Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se ky veprim i tyre përbën përsëritje të shkeljes së legjislacionit zgjedhor, pra ka bërë shkelje të tilla edhe në proceset e mëparshme zgjedhore. Kjo konsiston në faktin se Subjekti Politik LDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Andaj përfshirja e fotografisë në rrjetin social facebook nga kandidati i subjektit të tyre politik i cili ka vizituar Këshillin e Bashkësisë Islame, si dhe është takuar me përfaqësues fetar, për fushatë zgjedhore veprim i cili është në kundërshtim me dispozitën ligjore të nenit 5 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 i Rregullores Zgjedhore 07/2024.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 neni paragrafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, dhe nenit 5 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 i Rregullores Zgjedhore 07/2024, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
Anr.369/2025 më datën 07.02.2025

Kryesues i Panelit

Skender Çoçaj



Këshilla Juridike: Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.